



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

BASHKIA VAU I DEJËS

KËSHILLI

Nr. 1089 Prot.

Vau i Dejës, më 13.02.2024

**RAPORT MBI PUNËN E KËSHILLIT TË BASHKISË PËR 12 - MUJORIN E VITIT
2023**

Të nderuar këshilltarë !

Këshilli Bashkiak, si organi përfaqësues dhe vendimmarrës i qeverisë bashkiake, i ushtron përgjegjësitë e tij qeverisëse, duke respektuar parimet e demokracisë vendore, transparencës qeverisëse, ligjshmërisë, duke përdorur me ekonomi, efikasitet dhe efektivitet burimet njerëzore, financiare, fizike e natyrore si dhe teknologjike të Bashkisë.

Veprimtaria e Këshillit Bashkiak mbështetet në zbatimin e detyrimeve që burojnë nga ligjet, aktet nënligjore në zbatim të tyre si dhe rregulloret e miratuara nga vet këshilli. Gjatë vitit 2023 u zhvilluan zgjedhjet vendore dhe kemi një këshill të plotë me prezencën e një opozite. Mbledhja e konstitutimit të Këshillit Bashkiak Vau i Dejës u mbajt e hapur për qytetarët dhe u transmetua në transparencë të plotë livestream në facebookun e Këshillit Bashkiak.

Mëposhtë po paraqesim disa nga aktivitetet e Këshillit Bashkiak Vau i Dejës për vitin 2023:

Vendimmarrja

Gjatë vitit 2023 janë zhvilluar 30 mbledhje komisionesh me pjesëmarrjen e 80 këshilltarëve. Numri më i madh i mbledhjeve të komisioneve është ai i komisioneve të përhershme me 30 mbledhje.

Për periudhën Janar – Dhjetor 2023, janë mbajtur 14 Mbledhje të Këshillit Bashkiak, janë marrë në shqyrtim 110 projektvendime nga ato cilat janë miratuar 103 vendime gjithsej në Këshillin Vau i Dejës, nga të cilat për 87 vendime është shprehur pozitivisht për ligjshmërinë Institucioni i Prefektit të Qarkut Shkodër dhe 16 janë kthyer për rishqyrtim, ndërsa 7 projektvendime janë kthyer nga këshilli për plotësim.



Numrin më të madh të vendimeve e përbëjnë vendimet që kanë të bëjnë mbi dhënien në përdorim apo me qira të sipërfaqeve të fondit pyjor rreth 30%, pastaj vijnë vendimet në lidhje me dhënien e ndihmës ekonomike nga fondi i kushtëzuar deri në 6 % të cilat zënë rreth 11% të vendimeve të marra në total.

Mund të përmendim si vendime kryesore gjatë vitit të kaluar si:

1. Miratimi i tavanëve buxhetore për vitin 2024 dhe PBA 2024-2026.
2. Miratimi i vendimeve për dhënie ndihmë financiare familjeve që kanë pësuar dëme nga fatkeqësitë natyrore
3. Miratimi i vendimit për miratimin e vlerës maksimale të subvencionit të qirasë në tregun e lirë për vitin 2023.
4. Miratim i vendimit për ngritjen e komisionit të strehimit.
5. Miratim i vendimit për miratimin e planit të parandalimit dhe shuarjes së zjarreve në pyje dhe kullota për vitin 2023.
6. Miratim vendimi për miratimin e planit të mbarështimit të ekonomive pyjore Gomsiqe dhe Drin Gjader Kirë në administrim të Bashkisë Vau Dejës.
7. Konstituimi i Këshillit të ri Bashkiak.
8. Miratim vendimi “Për miratimin e Buxhetit të vitit 2024 dhe programit Buxhetor Afatmesëm Përfundimtar 2024-2026, numrin e punonjësve për Bashkinë Vau Dejës”.

Mbledhjet frekuentohen nga mesatarisht 71% e këshilltarëve. Rreth 29% e këshilltarëve nuk e frekuentojnë mbledhjen e këshillit.

I gjithë dokumentacioni projekt vendimeve të shqyrtuara gjatë mbledhjeve të Këshillit është publikuar në faqen web të këshillit për tu dhënë mundësi qytetarëve të njihen me to. Në regjistrin online për transparencën e mbledhjeve të këshillit janë dokumentuara të gjitha informacionet mbi mbledhjet duke filluar nga thirrja e mbledhjes, oraret e mbajtjes, videot e mbledhjes dhe proces verbalet tyre. Mbledhjet e Këshillit janë transmetuar të gjitha online në facebook të Këshillit Bashkiak. Kjo i jep Këshillit Bashkiak një pavarësi në transmetimin pandërprerje livestream të mbledhjeve dhe i krijon mundësi të jetë transparent në lidhje me të gjitha vendimet që merr dhe problemet që trajton për ti ardhur në ndihmë qytetarëve.

Kërkesat dhe ankesat e qytetarëve

Në Këshillin Bashkiak Vau i Dejës për periudhën Janar-Dhjetor 2023 janë regjistruar 8 kërkesa të cilat janë trajtuar shkresërisht. Pjesa më e madhe kërkesave ka qënë për problemet e ish pronave dhe për hapje rrugësh të reja etj. Ka shumë pak ankesa nga qytetarët, me të cilët duhet shtuar komunikimi për ti ftuar ata të adresojnë shqetësimet e tyre tek Këshilli Bashkiak.



Gjatë kësaj periudhe nuk ka patur peticione dhe nisma të qyterarëve te depozituara në Këshill. Këshilli Bashkiak në kordinim me Bashkinë do ti japë përgjigje të gjithë shqetësimeve të qytetarëve me mundësitë që ka në dispozicion. Të gjitha kërkesat dhe ankesat janë të publikuara në regjistrin online të kërkesë-ankesave në faqen web të Këshillit Bashkiak.

Konsultimi me publikun

Këshilli Bashkiak i ka kushtuar vëmendje të veçantë dëgjësive publike per projektaktet per te cilat kerkohet nga ligji. Jane zhvilluar 31 degjesa publike per 31 projektakte, kryesisht projekt akte të dhënies me qera apo në përdorim të sipërfaqeve pyjore, kullosore apo pronave të tjera të Bashkisë me qëllim zhvillimi dhe përmirësimi të tyre, Për miratimin e taksave dhe tarifave vendore në Bashkinë Vau i Dejës, Mbi miratimin e Projektbuxhetit te Pare Afatmesem 2024-2026 në Bashkinë Vau i Dejës, janë zhvilluar 4 dëgjesa publike.

Në dëgjesa morën pjesë një numër i konsiderueshëm i banorëve, qytetar, biznese, grupe interesi, anëtar këshilli konkretisht, janë dhënë rekomandime të cilat janë marrë parasysh nga bashkia. Te gjitha informacionet per konsultimet e publikun jane publikuara ne regjistrin online per konsultimet me publikun ne faqen web te keshillit bashkiak.

Perveç konsultimeve me takime direkte keshilli ka konsultuar qytetaret edhe nepermjet pyetsorëve online. Nje pyetesori i tille u realizua per prioritetet e buxhetit per vitin 2024 ne te cilin moren pjese 61 qytetarë, prej te cilëve 54,2 % femra. Nga pyetsori u hartua një analizë me prioritetet e qytetareve per tu reflektuar ne buxhet.

Aktivitetet kryesore të Këshillit

Gjate vitit 2023 në bashkëpunim me Projektin Bashki të Forta është realizuar një trajnim 2 ditor për këshilltarët në ambientet e Këshillit Bashkiak.

Këshilli Bashkiak Vau i Dejës për aktivitetet e vitit 2023 kishte planifikuar të shpenzojë per 676.000 leke dhe nga kjo shume ka shpenzuar 100% te buxhetit te planifikuar. Këto shpenzime vetëm për aktivitetet e Këshillit Bashkiak dhe shpenzimet per honoraret e këshilltareve janë të përjashtuara nga kjo shumë.

Pjesa më e madhe e buxhetit është shpenzuar për blerjen dhe montimin e mikrofonëve në sallën e Këshillit Bashkiak,shpenzime per kancelari dhe shpenzime te tjera për mbarëvajtjen e aktiviteve te Këshillit Bashkiak.

Këshilli Bashkiak ka miratur planin e Aktiviteve, Vendimarrjes dhe Konsultimeve për vitin 2024 të shoqëruar me një buxhet prej 4.736.000 lekësh.

Këshilli Bashkiak ka marrë pjesë në aktivitete të organizuara për veprimtari të ndryshme si psh: Takim me shoqata të ndryshme joqeveritare që operojnë në Bashkinë tonë



Këshilli Bashkiak këtë vit ka organizuar 2 fushata advokimi në facebookun e Këshillit Bashkiak për të nxitur pjesëmarrjen e qytetarëve në vendimarrje, duke i ftuar qytetarët të bëhen pjesë aktive në dialogun me qeverisjen vendore, të përdorin instrumentet e Këshillit për zgjidhur problemet e tyre dhe për ti kërkuar llogari apo të zgjidhin problemet e tyre nëpërmjet kërkesë/ankesave që mund të drejtojnë te Këshilli, mund të ndjekim mbledhjet online apo të marrin pjesë në dëgjuesat publike për projekt akte të ndryshme apo për buxhetin e Bashkisë.

Sekretari i Këshillit

ARDIAN ÇELEPIJA

